



[www.lezha.gov.al](http://www.lezha.gov.al)

# bashkia ime

Botim i Bashkisë Lezhë, i përmuajshëm, Nr. 2, qershor 2017


## Lexuesit kampionë të Lezhës...



Bashkia Lezhë çel sezonin e ri, fq 9





Qendër e re për shëndetin e gruas, fq 12



Kuvendi i Troshanit, Monument kulture, fq 17



Sporti - një sezon plot medalje, fq 22



### Redaksia

Drejtoria e Integritimit në BE dhe Programeve të Zhvillimit  
Lajmet: Altin Mema, Rrok Lelçaj, Gjergj Figuri  
Fotot: Olsi Tetaj  
Redaktorë: Hekuran Koka, Xhulia Lekaj  
Design: Hekuran Koka, Evaristo Coli  
www.lezha.gov.al, pzhvillimi@lezha.gov.al

### përmbajtja

PMIM - një plan për qytet të pastër	4
Studentët ende pa bursa	5
Turizmi, sektor i rëndësishëm	6
Dëgjesë publike për PBA	7
Aksione për pastrimin e bregdetit	8
Bashkia Lezhë çel sezonin e ri	9
Fillim i mbarë i sezonit	10
Shëngjini sistemohet largimi i ujërave të ndotura	11
Qendër e re për shëndetin	12
Sensibilizim mbi dhunën në familje	13
Lexuesit kampionë të Lezhës...	14
BESLIFEST - një festë talentesh	16
Kuvendi i Troshanit Monument kulture	17
Festohet në Lezhë Një Qershori	19
Festivali Kombëtar i Valles Popullore	20
Rikthehet Festivali i këngës për fëmijë	21
Sporti - një sezon plot medalje	22
Dita botërore kundër punës së fëmijëve	23
Investitorë të bujqësisë nga Izraeli në Lezhë	

## PMIM - një plan për qytet të pastër

Në vitin 2010, Bashkia ka filluar një projekt për menaxhimin e integruar të mbetjeve në Bashkinë Lezhë ku në bashkëpunim me DLDP është rikonstruktuar qendra e riciklimit me një vlerë prej 40 mijë euro nga DLDP-ja dhe rreth 20% bashkëfinansim i Bashkisë Lezhë. Kjo qendër fillimet i kishte të mira por që më pas nuk funksionoi për arsye të problemeve me operatorët privatë të riciklimit me Bashkinë e vjetër të Lezhës. Në kuadër të PMIM 2017-2021, Bashkia Lezhë ka parashikuar mbledhjen e mbetjeve voluminoze, dhe për këtë synon kthimin e qendrës së riciklimit në një qendër grumbullimi të këtyre mbetjeve.

Bashkia vitin që shkoi ka përfunduar Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2017-2021, plan që është hartuar nga Bashkia Lezhë me asistencën teknike të Institutit të Kërkimeve Urbane (URI) dhe me mbështetjen financiare të DLDP-së dhe Helvetas Sëiss Intercooperation. Nëpërmjet Planit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2017 - 2021, Bashkia do të synojë grumbullimin e mbetjeve në të paktën 95 % të territorit dhe do të përmbushë të gjitha detyrimet për reduktimin deri në 50 %

të mbetjeve nëpërmjet riciklimit dhe kompostimit, kështu do të arrijë të gjitha objektivat kombëtare dhe kriteret e integritimit Evropian. Në kuadër të këtij Plani është vlerësuar se arritja e objektivave në harkun kohor 2017 - 2021, do të kushtojë Bashkisë Lezhë afërsisht 83 milionë lekë në vit. Kjo kosto parashikon mbulim tërësor të shërbimit të 10 njësive administrative të Bashkisë Lezhë që nga blerja e konteniereve, mjeteve të transportit, fuqia punëtore, marrja e mbetjeve nga kontenierët dhe deri në depozitim në landfill, proces që është parashikuar të kryhet nga kontraktorët e Bashkisë Lezhë.

Është bërë një analizë e plotë si dhe në kuadër të bashkimit të 10 njësive në Bashkinë e madhe të Lezhës është bërë Plani i Menax-



himit të Integruar të Mbetjeve Urbane 2017-2021 ku Bashkia Lezhë është ndarë në 3 (tre) zona shërbimi si më poshtë:

- Zona I – Lezha dhe Shëngjini
- Zona II – Kolsh, Zejmen dhe Shënkoll
- Zona III – Balldre, Blinisht, Dajc, Kallmet dhe Ungrej

Plani i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2017-2021 të Bashkisë Lezhë është e hartuar bazuar në kushtet e reja të krijuara pas reformës territoriale duke u mbështetur mbi një analizë të gjendjes aktuale, të karakteristikave kryesore që lidhin elementët e planifikimit si dhe në përputhje me legjislacionin, dokumentat strategjike dhe synimet e Shqipërisë në procesin e integritimit Evropian. PMIM parashikon mbledhjen e mbetjeve në dy rryma si dhe janë parashikuar tabelat përkatëse duke filluar nga viti 2017 deri 2021. Theksojmë faktin se jemi në muajt e parë të fillimit të implementimit të këtij procesi. Shërbimi në Bashkinë Lezhë është parashikuar të bëhet sipas zonave të shërbimit, shërbim i cili do të realizohet nga kontraktorët privat sipas kostove të llogaritur në PMIM.

## Ministria e Arsimit ende nuk ka shqyrtuar dhe miratuar shtesat e bursave për Bashkinë Lezhë

Sipas VKM-së 903 dt. 21.12.2016, afati i fundit për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për vitin akademik 2016-2017 ishte data 31 janar 2017. Mbi këtë bazë, Drejtoria e Arsimit, Kulturës e Turizmit, me datë 27.01.2017, ka dorëzuar për shqyrtim në Këshillin Bashkiak projekt-vendimin për bursat. Më datë 31 janar 2017, me shkresë zyrtare jemi njoftuar nga Ministria e Arsimit për shtesën e numrit të bursave për Bashkinë Lezhë, nga 45 në 55 në total. Në këtë situatë, Këshilli Bashkiak ka shtyrë mbledhjen, më datë

2 shkurt 2017. Pas miratimit, Vendimi i Këshillit të Bashkisë Lezhë, nuk është pranuar për t'u zbatuar nga disa fakultete, me argumentin se është i pavlefshëm për shkak të miratimit përtej afatit të parashikuar në ligj. Theksojmë se, vendimi i Këshillit të Bashkisë është konfirmuar edhe nga institucioni i Prefektit të qarkut Lezhë. Ndodhur në këto kushte, si dhe duke vepruar në analogji me praktika të njëjta të viteve të mëparshme, Bashkia Lezhë, zyrtarisht i është drejtuar Ministrisë së Arsimit, më datë 27 mars 2017 për të zg-

jidhur këtë problematikë. Ende nuk është kthyer një përgjigje në lidhje me problemin në fjalë. Bëjmë me dije se, shkresa e Ministrisë së Arsimit për shtimin e numrit të bursave e mbërritur në protokoll më datë 31 janar 2017 (dita e fundit për vendimarrjen në Këshill sipas VKM-së 903/2016), përbën shkak të arsyeshem për të legjitimuar vendimarrjen e Këshillit më datë 2 shkurt 2017. Proçeduralisht dhe në raport me fakultetet, është përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi.



## Turizmi, sektor i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik



Në strategjinë e saj të zhvillimit Bashkia Lezhë ka si prioritet kryesor fuqizimin dhe vënien më mirë në efikasitet të sektorit të turizmit. Industria e turizmit si industria më fitimprurëse po shikohet si përparësi jo vetëm në turizmin bregdetar, por gjithashtu në atë malor, historik, kulturor, religjioz dhe kulinar. Njohja, identifikimi dhe promovimi i këtyre vlerave turistike që ka Lezha, ka qënë objekt i një seminari të organizuar nga Fondacioni Mary Ward Loreto dhe Bashkia Lezhë. Në këtë takim u theksua nevoja e bashkëpunimit me institucione të shtetit, komunitetin e biznesit, agjensi turistike, shoqata dhe fondacione të ndryshme që mund të kontribuojnë në gjithë përmirësimin e infrastrukturës turistike, me qëllim

për ta bërë Lezhën në prag të këtij sezoni turistik sa më tërheqëse për vizitorët, pushuesit dhe turistët e huaj. Sekretarja e Kryqit të Kuq, dega Lezhë, Florinda Gjergji, theksoi se është e rëndësishme që të prodhohmë ide jo vetëm në përmirësimin e jetës së familjeve në nevojë, por gjithashtu në përgatitjen dhe trajnimin e specialistëve të kualifikuar sipas standarteve europiane, që ndihmojnë në rritjen e cilësisë së shërbimeve në sektorin e turizmit. Përgjegjësi i sektorit të Turizmit pranë Bashkisë Lezhë, Gjergj Figuri, u ndal tek sfidat dhe sugjerimet për një turizëm sasior dhe cilësor, duke theksuar si parësore nevojën për të promovuar. Përfaqësuesja e Fondacionit “Mary Ward Loreto” Afërdita Gjoni, solli në këtë takim

një iniciativë të rinjve të Njësise Administrative Kallmet, të cilët përmes ekspozitave fotografike po promovojnë burimet turistike të kësaj zone që kanë të bëjnë kryesisht me turizmin malor, kulturor, etnografik dhe religjioz. Më pas, përfaqësues të biznesit dhe kulinarisë diskutuan mbi faktorët që e bëjnë të suksesshëm cilësinë e shërbimit dhe artin e të gatuarit. Sollën përvojën e tyre në këtë drejtim, pronari i “Rapsodisë” Alfred Marku, i “Hyllit të Dritës” Preç Ndoj, dhe i “Mrizit të Zanave” Altin Prenga. Në këtë seminar gjithçka ishte në shërbim të zhvillimit të turizmit, rritjes së numrit të pushuesve, të turistëve të huaj, në popullimin e plazheve dhe shtimin e vizitorëve në pikat e tjera turistike që ka Lezha.

## Dëgjuesë publike e planit të Buxhetit Afatmesëm 2018-2020

Bashkia Lezhë ka organizuar Dëgjuesën e parë publike mbi planin e programimit të Buxhetit Afatmesëm 2018-2020. Në këtë prezantim kanë marrë pjesë qytetarë të Lezhës, intelektualë, drejtues të Dhomës së Tregtisë, biznesmenë, grupe të tjera interesi, media, shoqata joqeveritare dhe organizata të ndryshme. Zv.Kryetari i Bashkisë Lezhë, Z.Enver Hafizi, u ndal tek prioritetet kryesore të investimeve në programin për buxhetin afatmesëm, duke treguar transparencë para pjesëmarrësve, për çdo pyetje, sugjerim dhe diskutim. Ndërkohë, drejtorët e drejtorive të Bashkisë bënë një pasqyrë të shkurtër për tavanët e shpenzimeve buxhetore, shërbimet publike, infrastrukturën rrugore, planifikim-zhvillimin e territorit dhe të ekonomisë, strehimin dhe shërbimet sociale, për kulturën, sportin dhe investimet në turizëm. Në këtë dëgjuesë publike, u prezantuan gjithashtu problemet dhe investimet programore që lidhen me mbrojtjen civile, sigurinë publike, ruajtjen e mjedisit, mirëadministrimin e pyjeve dhe kullotave, mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Sfida e Bashkisë Lezhë mbetet ofrimi dhe rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve, të cilët njëkohësisht duhet të ndërgjegjësohen që të kryejnë rregullisht cdo detyrim taksor ligjor. Kështu, Bashkia Lezhë mbylli fazën e parë të Dëgjuesës Publike për Planin Buxhetor Afatmesëm 2018-2020. Diskutimet u shtrinë në të gjithë sektorët.



## Pastronet vija bregdetare e plazhit të Tales



Një nismë shumë e rëndësishme e Bashkisë Lezhë në bashkëpunim me njësinë administrative Shënkoll, ka qënë ai i pastrimit të tri kilometrave vije bregdetare në Tale të Lezhës. Brenda pak ditësh pritet që plazhi të jetë gati për të pritur pushuesit. Aktualisht po punohet për pastrimin e rërës. Punonjësit e Shërbimeve Publike në Bashkinë e Lezhës kanë punuar për largimin e mbeturinave të sjella në breg nga deti me qëllim që pushuesit të gjejnë një ambient sa më të pastër dhe mikëpritës. Në një fjalim të mbajtur nga administratori i njësisë administrative Shënkoll, Z. Albert Rrusti, është shprehur që sezoni turistik do të kushtohet një vëmendje maksimale, ku gjithashtu është marrë një konfirmim për pajisjen e mjeteve të urgjencës gjatë gjithë periudhës që do të zgjasë sezoni turistik. Bashkia Lezhë në bashkëpunim me njësinë administrative Shënkoll do të jenë prezent gjatë gjithë kohës që do të zgjasë qëndrimi i pushuesve.

## Universiteti i Tiranës kontribut në pastrimin e plazhit të Shëngjinit



Dhjetëra studentë të Universitetit të Tiranës kanë marrë një aksion për pastrimin e bregdetit të Shëngjinit, duke u përqendruar kryesisht në plazhin e Kunës. Një nismë e tillë vjen paralel në të gjithë bregdetin e mesdheut. Pedagogu i Fakultetit Filologjik Z. Romeo Hanxhari thotë se, dëmët nga mbetjet janë të pariparueshme, ndaj edhe duhen masa urgjente për parandalimin e tyre. Nga ana tjetër Bashkia Lezhë nëpërmjet zëdhënësit Altin Mema, bëri me dije se vëmendja e pushtetit vendor do të jëtë maksimale gjatë gjithë sezonit turistik në përmirësimin e kushteve për këtë zonë të bregdetit. Numri i pushuesve sa vjen dhe rritet në Shëngjin, ndërsa Bashkia bën me dije se sezoni turistik hapet me datë 2 qershor.

## Bashkia Lezhë çel sezonin e ri turistik

Plazhi i Shëngjinit dhe i gjithë bregdeti i Lezhës kanë nisur të popullohen me pushues vendas dhe të huaj. Fluksi i tyre ka ardhur duke u rritur më shumë në fundjavë. Ditët me diell dhe rritja e temperaturave kanë nxitur lokalet dhe hotelieritë që të hapin dyert për turistët. Gjithçka duket se është bërë gati. Për të garantuar një fillim të mbarë të këtij sezoni, Bashkia e Lezhës ka marrë të gjitha masat e duhura në përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe krijimin e kushteve sa më komode për pushuesit që pritet të jenë më të shumtë në numër këtë vit. Bregdeti i Shëngjinit ka qënë dhe vendi i organizimit të hapjes së sezonit të ri turistik. Me sloganin “mire se vini në Lezhën turistike” janë promovuar resurset, bukuritë natyrore të bregdetit, asetet historike, arkeologjike, etnografike dhe trashëgimia e pasur kulturore. Me interes u ndoq panairi i artizanatit dhe kulinarisë. Në stendat e këtij panairi prodhuesit e ardhur nga gjithë njësitë administrative të Lezhës, kishin ekspozuar me kujdes produktet e tyre bujqësore dhe të artizanatit, ku binin në sy qendismat dhe pëlhurat e tejzgjahut të Zadrimës, kostumet popullore të traditës dhe prodhime të tjera artistike. Më pas ceremonia e hapjes së sezonit të ri turistik vijoi me një koncert festiv ku interpretuan këngëtarë, vallëtarë dhe instrumentistë të grupeve artistike të Lezhës. Në fjalën e tij përshëndetëse Kreu i Bashkisë së Lezhës Fran Frrokaj evidentoi ndryshimet e bëra këtë vit në rrjetin infrastrukturor turistik të bregdetit, ku ndër të tjera veçoi pastërtinë e mjedisit, rregullin, qetësinë dhe sigurimin me ujë të pishëm 24 orë pa ndërprerje. Qytetarë të Lezhës, pushues dhe të ardhur nga vendet fqinjë u shprehen entuziastë për një fillim dhe vijim të mbarë të këtij sezoni të ri turistik.



# Fillim i mbarë i sezonit në Shëngjin

Në Shëngjin turistët kanë pronotuar më herët dhe jashtë fluksit të përvitshëm. Përgatitjet në kohë për sezonin turistik kanë bërë që ky interes të jetë më i lartë se në vitet e shkuara. Kosovarët përbëjnë numrin më të lartë të këtyre pronotimeve, por shihet tendencë në rritje për pronotime nga turistët e huaj. Të shumtë janë hotelieritë që edhe në këtë periudhë kanë një fluks të kënaqshëm turistësh të akomoduar. Sipas edhe intervistave të disa operatorëve të ndryshëm, ka një rritje të fluskit dhe zgjerim të sezonit.

Esmeralda Bela, Menaxhere Hotelerie pranë Resort Ermiri, thekson që këtë vit interesi duket më i lartë se vitet e tjera dhe pushuesit kanë filluar të kontaktojnë kryesisht nëpërmjet rrjeteve sociale dhe e-mailit. Ndërsa Besnik Meta, Operator Turistik i Hotel Besa theksoi që ky sezon ka filluar më herët se vitet e tjera. Ndërsa vuri në pah që pushuesit janë më të interesuar

këtë vit duke pasur një prurje të madhe nga shtetet e ndryshme, por është për t'u theksuar që 80% të pushuesve janë nga Kosova. Dritan Kondakciu, Drejtor ekzekutiv i Resort President vuri në dukje që kërkesat janë të shumta dhe klientela ka ndryshuar, duke u rritur numri i pushuesve që vijnë nga Evropa Veriore, kryesisht nga Gjermania por njëkohësisht vihet re një rritje e kërkesës edhe nga Francezët që kanë shprehur dëshirën për të eksploruar sidomos Shëngjinin.

Pronotimet e shpejta kanë bërë që Shëngjini të shohë me perspektivë për të ndërhyre akoma më herët në ofrimin e shërbimeve përgjatë bregdetit për vitin e ardhshëm. Impakti i menjëhershëm ka bërë që zgjatja e sezonit të konceptohet si hapje e hershme e sezonit dhe të ofrojë shërbime më të mira për vizitorët dhe turistët.



# Shëngjini me sistem modern të largimit të ujërave të ndotura

Situata alarmante me ujërat e ndotura në qytetin e Shëngjinit tashmë po shkon drejt fundit. Një nga shqetësimet kryesore të viteve të kaluara, gjë e cila kishte penalizuar zhvillimin cilësor të turizmit në bregdetin tonë, kjo situatë këtë vit do të këtë një performancë totalisht ndryshe, pasi sistemi i ujërave të ndotura në Shëngjin po shkon drejt standarteve europiane, kjo falë projektit të Bashkimit Europian "Ndërtimi i Sistemit të Ujërave të Ndotura në Vlorë, Ksamil, Kavajë dhe Shëngjin", i financuar nga fondet IPA 2009 dhe në Lotin III kishte ndërtimin e këtij sistemi në qytetin e Shëngjinit, që tashmë është në fazën e përmbylljes dhe dorëzimit të punimeve

Punimet në kuadër të këtij projekti në Shëng-

jin mbulonin punimet për ndërtimin e sistemit të kanalizimeve dhe tre stacioneve të pompimit. Kështu, për sistemin e kanalizimeve janë shtrirë gjithsej 11.72 km tuba të dimensioneve të ndryshme për tre nivelet e sistemit të kanalizimeve, janë ndërtuar 407 puseta të vogla propileni si dhe 42 puseta të mëdha prej betoni, si dhe janë lidhur 298 banesa me sistemin.

Gjithashtu janë ndërtuar tre stacione pompimi, dy pranë stacionit të policisë dhe një në Kunë duke përfshirë të gjitha instalimet elektro mekanike. Gjithashtu është ndërtuar edhe sistemi kryesor i largimit prej 3 km, dhe i gjithë sistemi është certifikuar nga supervisorin i caktuar nga Delegacioni i Bashkimit Europian në Tiranë, dhe tashmë është gati për t'u vënë në punë.



## Qendër e re për shëndetin e grave dhe fëmijëve në Lagjen Nënë Tereza

Shumë shpejt, Lezha do të ketë një qendër shëndetësore multifunktionale që do t'i vijë në ndihmë e trajtojë në vijimësi shëndetin e gruas e fëmijës e cila për nga dimension, cilësia dhe fokusi i veçantë përbën një zhvillim real për zonën tonë. Kjo qendër do të ndihmojë në decentralisimin edhe të shërbimeve shëndetësore dhe të përkujdesjes sociale. Shoqata humanitare "Operae life" në bashkëpunim me donatorë të ndryshëm si dhe me bashkëfinancimin dhe bashkëpunimin e ngushtë me Bashkinë Lezhë po punon për ngritjen e "Qendrës shëndetësore të gruas dhe fëmijës" në lagjen "Nënë Tereza", Lezhë.

Qendra shëndetësore për gratë dhe fëmijët do të jetë e orientuar në përmirësimin e kulturës së

parandalimit, dhe synon të shpërndajë praktikat më të mira social shëndetësore duke filluar ato të higjienës dhe edukatën e të ushqyerit në përputhje me zakonet dhe traditat lokale, duke promovuar disa metoda parandaluese të provuara më parë si dhe duke nxitur fuqizimin e grave. Qendra gjithashtu ka për qëllim të ndërhyjë në situatat e vuajtjes sociale dhe të nxisë ndërgjegjësimin dhe të promovojë të drejtat e grave dhe fëmijëve. Praktiskisht, në fund të një procesi dy-vjecar verifikimi, bashkarisht me personelin e strukture sociale-sanitare lokale, në vecanti me zyrën rajonale të shëndetit, marrja e stileve të tjera jetese, njohja e praktikave higjieniko-sanitare në bazë.



## Sensibilizim mbi dhunën në familje

Vendi ynë vazhdon të ketë tregues të lartë shifrash për dhunën edhe pse ka masa për dënimin e saj. Shifrat e dhunës së denoncuar janë shumë të ulëta në krahasim me shifrat e dhunës reale. Dhuna ndaj grave evidentohet në shumë forma, që nga mjediset shtëpiake në ambjentet e punës, që nga presionet psikologjike deri tek dhuna fizike dhe vrasjet. Në dhjetor 2006, Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratoi një ligj të ri në ndihmë të viktimave të dhunës në familje, ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" (ligji kundër dhunës në familje). Qëllimi i ligjit është që të parandalojë dhe reduktojë dhunën në familje në të gjitha format e saj dhe të mbrojë viktimat e saj.

Duke marrë parasysh këtë fenomen kaq problema-

rik, Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë pranë Bashkisë Lezhë, konkretisht specialistët e Barazisë Gjinore e Kundër Dhunës në Familje, kanë ndërmarrë një projekt sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi që nga muaji janar deri në dhjetor të 2017. Qëllimi i këtij projekti është sensibilizimi i komunitetit mbi dhunën në familje duke i informuar mbi llojet e dhunës, shkaqet e pasojat e saj dhe institucionet ku mund të kërkojnë mbrojtje të cilët kanë detyrime dhe përgjegjësi ligjore për tu ardhur në ndihmë këtyre viktimave. Takimet janë zhvilluar pranë qendrave shëndetësore në fshatrat; Grykë Manati, Kolsh, Ishull-Lezhë, Markatomaj, Bërzanë, Rrilë, Tale, Shënkoll, Torovicë, Pllanë, Zejmen, Shëngjin dhe do të vazhdojnë takimet në të gjitha fshatrat e të gjithë Njesive Administrative të qytetit të Lezhës.



# Lexuesit kampionë të Lezhës...

Nga **SUELA BALA**

Ia dolëm! Faleminderit! Shkolla mbaroi e bashkë me të edhe viti i parë i Bibliotekës Shëtitëse! Njihni lexuesit kampion të Lezhës... Nxënësit e mësues Arben Skandaj në shkollën fillore Blinisht kanë lexuar 23 libra në një muaj! Secili prej tyre! Ata janë të bukur sot, ndërsa do të jenë emra krenarie për familjet e tyre dhe Lezhën nesër, sepse janë të etur të lexojnë e të pushtojnë botën përmes librave. :) Faleminderit për kënaqësinë e madhe të njohjes me ju dhe për shijen e lumtur të shpërblimit për një punë të filluar me zemër, më

shumë sesa me mend... Prej fillimit të Nëntorit 2016, Biblioteka e Lezhës nisi për herë të parë në historikun e saj, një shërbim të ri për fëmijet dhe nxënësit që banojnë në fshat – Bibliotekën Shëtitëse - si një praktikë që përmbush detyrimin e shërbimit ndaj qytetarit aty ku ai jeton. Filluam me guxim, falë mbështetjes së qytetarëve dhe të administratës së Bashkisë, të cilët iu përgjigjën thirrjes tonë për të sjellë libra nga shtëpitë e tyre, ose kontribute financiare që të mund të blinin libra për lexuesit e rinj. Kështu nisëm udhëtimin në 32 shkolla të zonës rurale, me mjete transporti që I mundësoi bujarisht World Vision, duke gjetur në çdo

shkollë dashamirësinë e mësuesve për ta besuar dhe ndihmuar këtë inisiativë.

Në Dhjetor 2016, Biblioteka Shëtitëse nuk ishte më thjesht një përpjekje - Bashkia Lezhë u vlerësua me çmimin e parë në nivel kombëtar për praktikat më të mira innovative të qeverisjes vendore, me Bibliotekën shëtitëse. Ky çmim i financuar nga Qeveria Zviceriane, shpërbleu projektin tonë me 10 000 franga zvicerane. E gjithë shuma u përdor për blerjen e 1000 librave të rinj dhe të një makine e cila është përshtatur me rafte, duke u kthyer në një "bibliotekë me rrota".

Me një makinë – bibliotekë, përplot me libra, ne nisëm shërbi-



min e rregullt me kartela për çdo nxënës të interesuar në secilën shkollë të fshatrave të Lezhës, me një qëllim të kthjellët – çdo nxënës t'i gëzohet "makinës së librave", e cila një ditë në muaj viziton shkollën e tij. Secili prej tyre, që është anëtarësuar në bibliotekë, pasi e lexon vetë librin që ka marrë, shënon në librezën personale emrat e shokëve që kanë lexuar të njejtin libër. Ata shohin listën e librave që shtohet në kartelën e tyre, duke e shijuar leximin si një përvojë që e ndajnë me njeri-tjetrin.

Tanimë në mbyllje të vitit shkollor ne kemi 1280 anëtarë të bibliotekës shëtitëse, ndërsa që nga fëmijët e kopshteve e deri maturantët, kanë qarkulluar nëpër duar 1700 libra, në harkun kohor të 8

muajve: Nëntor 2016-Qershor 2017. Këto libra janë lexuar nga më shumë se 7000 nxënës! Përveçse një kënaqësi e madhe, ky impakt ka tejkaluar çdo pritshmëri tonën të fillimit, duke na provuar të gjithëve sa shumë u detyrohemi fëmijëve e të rinjve tanë për t'u ushqyer dëshirën, vullnetin dhe energjinë që kanë. Mirënjohje për çdonjerin prej mësuesve, që me shumë përkushtim ka ndihmuar në mbarëvajtjen e kësaj nisme. Falenderime për miqtë e shumtë të Bibliotekës shëtitëse, të cilët na kanë besuar, mbështetur dhe ndihmuar që të vazhdojmë të sigurt këtë rrugëtim me libra; pasi gjithsesi na bashkon Biblioteka shëtitëse. Udhëtimi ynë rinis në shtator... Mirë u takofshim!





## BESLIFEST - një festë talentesh

Nga SUELA BALA



Mësuese Nora më ftoi të isha në jurinë e BESLIFEST – “se kam fëmijë shumë të mirë” – belbëzoi në telefon dhe unë shkova e bindur se do të kishin përgatitur diçka të bukur, siç dinë fëmijët. Por nuk prisja kurrsesi, atë që gjeta në skenën modeste të shkollës 9 vjeçare Besëlidhja, të premten 9 Qershor.

Këngë të mëdha nga muzika jonë dhe e huaj u interpretuan live nga 17 nxënës të kësaj shkolle. U dridheshin duart ndërsa këndonin këngë si Halelujja, Refuzoj, A Man's World, Pragu i vegjëlisë, Valsi i Lumturisë, SUS, Stay, etj, të gjitha këngë nga repertori më i zgjedhur e i vështirë i muzikës së lehtë.

Alesio Arapi, nxënës i klasës së pestë fitoi vendin e parë me Pragu e Vegjëlisë, të cilin e meritoi për emocionin që përcolli, saktësinë intonative dhe shtrirjen vokale – tha kryetarja e Jurise Albana Përvathi.

Nën kujdesin e mësueses së talentuar të muzikës Nora Haxhia, ata befasuan, duke guxuar bukur të dëshmojnë talentin dhe zotësinë e tyre.

Ata janë pasuri e këtij qyteti dhe e ardhmja e bukur e skenave të Lezhës :)

## Lule për libra, një projekt i bukur



Ata janë të vegjël, por dinë të lenë gjurmë në jetën e qytetit. Nxënësit e mësueses së përkushtuar Lulëzime Celami në shkollën Besëlidhja, prej klasës së parë punojnë me projektin për Edukim Ekonomik. Tanimë në fund të klasës së pestë ata dëshmuar se dinë të jenë të përgjegjshëm dhe të dhurojnë me bujari frutet e punës së tyre.

Me fara dhe filiza mbollën lule, u kujdesën vetë për to, i rritën në klasë, pastaj me materiale të riciklueshme i zbukuruan për t'i shitur në rrugët e qytetit. Kush bleu lule, mori dhuratë një pergamenë me thënie të zgjedhura nga vetë ata me mendime positive, që “të kthejnë buzëqeshjen”. Pastaj me lekët e fituara arritën të blejnë 54 libra, të cilat ia dhuruan bibliotekës së shkollës.

Ata janë fëmijë 12 vjeçarë të bukur e të zotët, të cilët me një mësuese - edukatore të mirë, I dhanë qytetit një shembull mbresëlenës, se dinë dhe munden t'i japin vlerë punës dhe mundit, duke na mësuar si të gëzohe mi me njëri – tjetrin e të jemi të dobishëm me punë të vogla, që vlejshme shumë.

Fëmijët festojnë me zemër, shohin me ngjyra dhe përkushtohen plotazi me gjithë fuqinë !

## Kuvendi i Troshanit, kolegji i gjuhës shqipe, Monument kulture

Në mbledhjen e fundit të Këshillit Kombëtar të Restaurimit, iu dha statusi “Monument Kulture” Kuvendit të Troshanit. Kuvendi i Troshanit, i ndodhur në Troshan të Lezhës, ka nxjerrë françeskanë të shquar si At Gjergj Fisha, Ambroz Marlaskaj, Leon Kabashi, Shtjefën Gjeçovi, Pashko Bardhi e shumë të tjerë, të cilët kanë lënë gjurmë në historinë dhe kulturën shqiptare. Kuvendi i Troshanit, është restauruar dhe sistemuar me shumë kujdes nga Provincia Françeskane Shqiptare. Ai zotëron ambiente të brendshme të bollshme dhe shumë të përshatshme për krijimin e një muzeu përkujtimor në nder të të gjithë figurave të ndritura françeskane shqiptare, duke u bërë kështu edhe një mundësi e shkëlqyer për turizëm kulturor. Në këtë Kuvend u shkollua dhe më vonë shërbeu At Gjergj Fishta. Kuvendi i Troshanit ndodhet jo larg fshatit Fishtë, aty ku etërit françeskanë në vitin 1639 erdhën në shkrepat e këtij fshati të Zadrimes duke ngritur një Kishë dhe një shtëpi të të varfërve. Më vonë, etërit françeskanë ishin ulur në vendin e tanishëm, ku me ndihmën e Austro-Hungarisë ndërjuan Kishën dhe Kuvendin në vitin 1857. Në vitin 1880, u dha leja e hapjes së kolegjit (shkollës) në këtë Kuvend që u inaugurua më 14 prill 1882, nga misionarët: At Mariano Pizzochini prej Palmanova, (Udine) dhe At Gian Pierro Ferrari, prej Bergamo.



## Nderimi i klerikut Dom Jak Zekaj

Me datë 28.05.2017 u vendos në fshatin Baqël të Lezhës shtatorja e studiuesit, përkthyesit e poetit Dom Jak Zeka, bust i cili do të qëndrojë si mikpritësi i parë në fshatin e tij të lindjes. Busti i Dom Jak Zekajt dhe sheshi me të njëjtin emër janë inaguruar në praninë e banorëve të zonës, klerikëve dhe drejtuesve lokal. Famulltari Dom Emiljan Paloka ka prezantuar jetëshkrimin për këtë personalitet që ju dedikua Zotit dhe vendit të tij.

Kryetari i Bashkisë Lezhë, Z.Fran Frrokaj, pasi vlerësoi sakrificën dhe kontributin e Dom Jak Zekës, nënvizoi se historia nuk duhet harruar, dhe se është detyrim i brezave të sotëm vlerësimi i figurave që i dhanë Zadrimes dhe mbarë Lezhës.

# Përkujtohet në Lezhë 5 Maji, Dita e Dëshmorëve

Është përkujtuar në qytetin e Lezhës 5-Maji, Dita e Dëshmorëve. Me këtë rast në varrezat e dëshmorëve bënë homazhe dhe vendosën kurora me lule drejtues të pushtetit lokal, veteranë të luftës, deputetë, familjarë të të rënve, përfaqësues të partive politike, punonjës të administratës publike dhe qytetarë të Lezhës. Në fjalën e tij përshëndetëse, Zv.Kryetari i Bashkisë Lezhë Z.Enver Hafizi vlerësoi shumë aktin sublim të dëshmorëve tanë që dhanë jetën për lirinë e vendit si dhe kontributin e veteranëve në luftën kundër pushtuesit të huaj. Prefekti i Lezhës Eduart Ndreca, solli mesazhin e tij të vlerësimit të aktit sublim të të rënëve për liri, ku ndër të tjera theksoi se do të nderojmë 5-Majin e çdo viti si pjesë e qenësishme e kujtesës tonë historike dhe si krenari e pasuri kombëtare me vlera të veçanta. Shqipëria që kemi sot është kontribut dhe sakrificë sublime e gjakut të derdhur nga dëshmorët tanë, që meritojnë të respektohen. Ndërkohë, Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës, Deli Bisha dhe anëtarë të tjerë të veteranëve të luftës, në këtë veprimtari homazh, evokuan heroizmin e dëshmorëve të Lezhës, që meritojnë nderim të veçantë dhe mirënjohjen më të thellë. Drejtues të Bashkisë së Lezhës, Prefekturës dhe Organizatës së Veteranëve bënë vizita në familjet e dëshmorëve. Zv.Kryetari i Bashkisë Lezhë Enver Hafizi bëri një vizitë në familjen e Heroit të Popullit Fran Ndue Ivanaj.



# Festohet në Lezhë 1 Qershori

Është festuar në Lezhë, 1-Qershori, festa e fëmijëve. Me këtë rast në mjediset e stadiumit “Besëlidhja” u mbledhën për të festuar 5 mijë fëmijë të 14 shkollave shkollave 9-vjeçare, të cilët zhvilluan veprimtari të shumta kulturore, artistike e sportive. Nga këta 300 nxënës dhe fëmijë parashkollor ishin pjesëmarrës dhe interpret në këto veprimtari. Shumë syresh kanë përfaqësuar shkollat e Lezhës në veprimtari kombëtare si; konkurse, olimpiada e aktivitete sportive. Fëmijët pjesëmarrës në festën e Një Qershorit i përshëndeti dhe kreu i bashkisë së Lezhës Fran Frrokaj, i cili duke ju uruar atyre gëzuar festën e Një Qershorit, përgezoji fituesit e garave sportive dhe i siguroi ata se do të kenë gjithnjë mbështetjen e bashkisë në zhvillimin e talenteve dhe

garantimin e kushteve optimale në kopshte e shkolla. Qindra fëmijë parashkollor dhe nxënës të qytetit të Lezhës dhe shkollave të tjera të njësive administrative festuan së bashku, duke përformuar me programet, koncertet e aktivitetet sportive të përgatitura enkas për këtë ditë. Bashkia Lezhë, në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rajonale, Qendrën Kulturore të Fëmijeve, Pallatin e Kulturës dhe Bibliotekën Publike kishin marrë të gjitha masat për mbarëvajtjen e gjithë veprimtarive. Këngët, vallet, lojrat, aktivitetet sportive dhe interpretimet e fëmijeve të Lezhës sollën gjallëri e jehonë gazmore në mjedisin e stadiumit “Besëlidhja”. Kjo ditë ishte kurorëzim i gjithë veprimtarive 1-vjetore të fëmijëve në kopshte dhe shkolla. Për fëmijët dhe nxënësit e dalluar u shpër-

danë çertifikata mirnjohjeje. Veprimtaritë e kësaj dite vijuan me hapjen e ekspozitës së punimeve në pikturë të fëmijëve me të talentuar të shkollave të Lezhës. Ishin përzgjedhur 74 piktorë të vegjël, të cilët ekspozuan 352 punime. Drejtori i Galerisë së Arteve Ymer Metalia vlerësoi punën, talentin e tyre dhe perkujdesjen e mësuesve të vizatimit. Ndërkohë drejtori i Kulturës, Turizmit, Arsimin dhe Sportit, pranë Bashkisë Lezhë, Ardjan Laçi shprehu gatishmërinë e këtij institucioni për mbështetjen e inkurajimin e fëmijëve të talentuar në shkolla.

Festimet e 1-Qershorit vazhduan gjatë gjithë orëve të paraditës, ku mjediset e stadiumit “Besëlidhja”, sheshi para bashkisë dhe Galeria e Arteve Figurative ishin “pronë” e fëmijëve të Lezhës.



# Festivali Kombëtar i Valles Popullore Burimore, Lushnje



20

QKVF në bashkëpunim me Bashkinë Lushnje organizuan Edicionin e VIII-të të Festivalit Folklorik Tipologjik Kombëtar të Valles Popullore Burimore i cilio rezultoi një sukses. Festivali u organizua në bazë qarqesh ku konkuruan grupet përfaqësuese të valleve nga qarqet: Kukës, Dibër, Lezhë, Durrës, Elbasan dhe Gjirokastrë. Grupet u paraqitën në mënyrë të denjë dhe salla ishte e mbushur, madje natën e dytë ishte e tejmbushur me spektatorë. Festivalin e përshëndetën grupet e valles K.V. “Agim Ramadani” nga Komuna Gjilan, Kosovë, K.V. “Jahi Hasani”, Çegan, Gostivar, Maqedoni dhe Grupi i Valles “Visaret e Krrabës”, Krrabë Tiranë. Juria përbëhej nga Mjeshtri i Madh Z. Rexhep Çeliku – Koreograf dhe Valltar, Mjeshtrë e Madhe Znj. Liljana Cingu – Valltare, Gerti Druga – Kompozitor, Nikoleta Allkanjari – Këngëtare, Rovena Dhima – Mësuese dhe Mjeshtrë e Kërcimit.

## Çmimet e vendosura nga juria ishin:

**Çmimi i Parë – Grupi i Valles, Qarku Lezhë**

Çmimi i Dytë – Grupi i Valles, Qarku Gjirokastrë

Çmimi i Tretë – Grupi i Valles, Qarku Durrës

Çmimi “Valltari më i mirë” – Vasjan Hysa, Elbasan

Çmimi i Karrierës – Rifat Ymeri, Dibër

Çmimi Valltarja më e mirë – Vjollca Harullaj Kukës,

Çmimi “Grupi me paraqitjen më autentike të kostumit tradicional shqiptar” – Grupi i Valles, Elbasan



# Rikthehet Festivali i këngës për fëmijë

Pas 25 vitesh ndërprerje, nën kujdesin e drejtpërdrejtë të Kreut të Bashkisë Lezhë Fran Frrokaj, rikthehet në skenë Festivali i Këngës për Fëmijë. Qendra Kulturore “Gjergj Lacaj” prej muajsh ka nisur punën për kurorëzimin me sukses të këtij eventi të rëndësishëm kulturor në jetën artistike të fëmijëve. Drejtori i Qendrës Kulturore për fëmijë, Z.Marçel Lacaj shprehet se krahas ringritjes së trupës artistike të teatrit të kukullave, krijimit të bandës muzikore, rikthehet në skenë dhe festivali i harruar i këngës për fëmijë. Në këtë festival të emërtuar “Erdhën Dallendyshet” u interpretuan 22 këngë, 18 prej të cilave ishin krijime të reja të muzikantëve e poetëve lezhjanë. Vlen të përmendet puna plot përkushtim e drejtuesit të muzikës Mark Gjoka, Mjeshtrë i Madh. Ndërkohë festivali solli një mundësi më shumë në evidentimin e talenteve të vegjël si në vokal ashtu dhe në instrumente muzikore. Kryetari i jurisë së festivalit Z.Zhani Ciko evidentoi risitë pozitive të këtij festivali. Në fund juria vlerësoi gjithë pjesëmarrësit në festival, interpretuesit e vegjël dhe krijuesit muzikor e letrar, me çertifikatë mirënjohjeje.



21

# Sporti - një sezon plot medalje



Me datë 1 Qershor, në Ditën Ndërkombëtare të fëmijëve i gjithë stadiumi i qytetit u mbush nga nxënës të shkollave, sportistë dhe artistë të vegjël. Kjo ditë shënoi edhe ndarjen e certifikatave për dhjetëra nxënës të dallur në fusha të ndryshme të shkencave. Gjithashtu u dhanë certifikata për sportistët e dalluar në sporte të ndryshme për rezultatet e tyre të larta, ku spikati Z. Luigj Vataj, i cili ka nderuar qytetin tonë me medalje ballkanike për moshat U 15 në sportin e Judos me trajner Altin Përgjegji. Kryetari i Bashkisë Z.Fran Frrokaj i uroi të gjithë fëmijët për ditën e tyre dhe i falenderoi për punën e palodhur që kanë bërë për të arritur rezultate pozitive, duke theksuar se Bashkia Lezhë do të bëjë maksimumin që të përkrahë këta talente si dhe do të ndihmojë në zbulimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të talenteve të rinj. Ndër rezultatet më pozitive për sportistët Lezhjanë këtë sezon mund të përmedim ekipin e futbollit të akademisë "Porto" me grupmoshat U 15, me trajner Klajti Reçi, të cilat kanë arritur të dalin në finalen e kupës. Gjithashtu disa certifikata u shpërndanë edhe për ekipet e tjera ku Lezha ka nxjerrë kampionë kombëtarë

si në Mundje, Karate, Kick-Boxing, Taekëon-Do, si pas kategorive. Lezha është një qytet me traditë në sporte ndeshëse, një popull që e don sportin, të rinj që duan të shprehin talentin e tyre në disiplina të ndryshme. Lezha e historisë, e kulturës dhe e traditës sportive, përveç sporteve tradicionale si futbollit, voljebolli apo mundja, vitet e fundit ka njohur disa sporte luftarake që janë pëlqyer shumë nga brezat e rinj. Që në vitin 1991 në vendin tonë erdhën disa sporte marciale, ndërsa në Lezhë erdhën pak më vonë, rreth viteve 97-98. U pritën pozitivisht nga të rinjtë, sportet si Judo, Karate të cilat kanë nxjerrë disa gjenerata kampionësh dhe medaljesh, si dhe u frekuentuan nga shumë të rinj e të reja të qytetit tonë. Pak më vonë erdhën dhe sporte të tjera si Taekëon-Do, Kick-Boxing, një risi për qytetin tonë. Klubi shumë sportesh në Lezhë na ka dhuruar disa herë kënaqësi duke ncxjerrë kampionë në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare, por për rezultate më të mira ka ende nevojë për mbështetje, sidomos për përmirësimin e terreneve sportive, dhe krijimin e kushteve të talenteve për stërvitje të vazhdueshme.

## Dita botërore kundër punës së fëmijëve



Në kuadër të Ditës Botrore Kundër Punës së Fëmijëve bashkia Lezhë në bashkëpunim me shoqata dhe institucione që veprojnë në qytet dhe njësitë e tjera administrative organizuan një takim sensibilizues kundër shfrytëzimit dhe punës së fëmijëve. Në këtë aktivitet u përcollën mesazhe që kishin të bënin me shkëputjen e fëmijëve nga rruga, mos shfrytëzimin në punë, shkollimin dhe integrimin e tyre në shoqëri. Shpesh herë pre e këtij fenomeni kanë rënë fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian. Ndaj u theksua në takim se, është mjaft i domosdoshëm kontributi i pushtetit vendor, i shkollave, shoqatave e organizatave të ndryshme që afrojnë shërbime direkte në parandalimin e viktimave që mund të bien pre e fenomeneve të tilla. Shenjat që tregojnë se fëmijët apo të rinjtë janë rekrutuar duke rënë viktime të punëve të rënda, vjedhjes, krimeve, të lypurit në rrugë dhe shpërndarjes së drogës, duhet të jenë sinjale alarmi për çdo qytetar, shoqatë dhe institucion shtetror.

## Investitorë të bujqësisë nga Izraeli në Lezhë



Kryebashkiaku i Lezhës z.Fran Frrokaj priti një grup investitorësh nga Izraeli. Në qendër të diskutimit ishte bashkëpunimi në fushën e bujqësisë kryesisht, apo edhe në infrastrukturë. Një ndër specialistët dhe biznesmenët më të fuqishëm në fushën e agrikulturës, që ka bërë emër në Izrael dhe në europë, z.Tamir Hamami, shprehu interes për krijimin e fermave për prodhime të ndryshme bujqësore. Kreu i Bashkisë Lezhë, z.Fran Frrokaj për kulturën e shalqinit i sugjeroi investim në fushën e Torovicës, mjaft e përshtatshme në kultivimin e kësaj kulture, ndërsa për kultura të tjera bujqësore i propozoi toka në zonën e Zadrimes, Zejmenit, Bregut të Matës etj. Frrokaj u zotua se bashkia do të jetë e gatshme në plotësimin e aspektit ligjor dhe krijimin e mundësive për investitorët e huaj dhe ata izraelit.



Bashkia Lezhë,  
Lagjia Skënderbeg,  
Sheshi "Gjergj Kastrioti",  
4501, Lezhë,  
info@lezha.gov.al  
www.lezha.gov.al